



Datë: 02.09.2025
Numër Protokolli: 5941/2025

A.nr.1364/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1364/2025 të datës 15.07.2025 të parashtruar nga ankuesi G.E, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1364/2025, e datës 15.07.2025, e parashtruara nga ankuesi G.E, ashtu që, detyrohet Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj kërkesën e datës 16.05.2025 të parashtruar nga ankuesi G.E, dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil G.E (*referuar tutje vetëm ankuesi*), më datë 15.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me realizimin e të drejtës për kompensim si anëtar i Komitetit të Auditimit të Brendshëm, sipas Vendimit të Ministrit të Punëve të Brendshme me numër protokolli Nr.0790/2021 të datës 13.12.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 27.08.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe se i njëjti sipas Akt emërimit me numër Nr.570 të datës 17.07.2020, mbanë pozitën e punës “*Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Kontratave*”, në Divizionin për Menaxhimin e Kontratave.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi më datë 16.05.2025, ka parashtruar Kërkesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të kompensimit për funksionin shtesë si anëtar i Komitetit të Auditimit të Brendshëm, në masën prej 20% të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për realizimin e kompensimit për funksionin shtesë si anëtar i Komitetit të Auditimit të Brendshëm. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, dhe të detyroj organin e punësimit që të realizoj kompensimin si anëtar i Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative*, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesën e datës 16.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e datës 15.07.2025, në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të parashtruar më datë 16.05.2025, dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1364/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, G.E;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.